

PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 16.09.2020
NUMERO:

04332



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ _____

Datë: 16.09.2020

PROCESVERBAL

i mbledhjes së IV-të (katërt) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/112 datë:11.06.2020, të parashtruar nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2021-2023.
2. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimit të mjeteve për COVID-19.
3. Shqyrtimi i kërkesës nr.04/113 datë:11.06.2020 për lirim të subjekteve afariste nga taksakomunale e ushtrimit të veprimtarisë për vitin fiskal 2020.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020.
5. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 29.05.2020 dhe filloi në ora 10:20.

Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 18 asambleistë, Kryetari i Komunës drejtorë komunalë, LMT-ja, përfaqësuesi i OSBE-së, dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! E hapi mbledhje e 4-ërt të Kuvendit të Malishevës. Të pranishëm në këtë mbledhje jemi 18 asambleistë, kuorrumin e kemi dhe mund të fillojmë më mbledhjen. Ata që e kanë deklaruar vonësën në mbledhje dhe mungesën në këtë mbledhje janë: Arlind Morina, Leonitë Kastrati, Demir Bajraj dhe Astrit Sertolli. Materialin e keni marrë pjesë pjesë deri sa janë përgatitur Ekzekutivi. Kur ata i kanë sjell materialet ashtu edhe ne i kemi përcjellur për te ju.

E hapi debatin për diskutimet jashtë rendit të ditës. Kush e do fjalën?

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Dua të ngrisë një çështje rreth akuzave që janë bërë ndaj udhëheqësve të UÇK-së nga Gjykata Speciale. Këtu shpreh të gjitha shqetësimet e mija dhe të subjektit tim për këtë çështje. Kjo Gjykatë pom nduket që e ka për detyrë që të njëllos vlerat e UÇK-së e jo që të vendosë drejtësi në vend. Ne jemi kundër formës së ndjekjeve së krerëve të UÇK-së e që për ne janë heronjë të gjallë për luftën e drejtë që kanë bërë.

Në fshatin tim ka filluar projekti i kanalizimit dhe punimet janë duke shkuar mirë, pres që pranimi teknik të jetë me përgjegjësi dhe të përcjellet puna.

Alban Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Po ndërlidhem me parafolësin dhe çfarëdo lloj gjykatë që del jashtë juridiksionin e saj do ta dëmtojë luftën e UÇK-së dhe më të pambrojturit janë ushtarët e kësaj ushtrie. Pra njëllojsja e UÇK-së ka ndodhur pikërisht nga kreret kryesor të saj që mbas luftës kanë fituar në emër të saj. Kjo çasje duhet të ndryshojë dhe lufta e UÇK-së është më e madhe se disa nga krerët e saj e që janë pjesë e politikës sot.

Shkaku i pandemisë nuk e dimë se si do të filloj mësimi në shtator dhe neve na interson aspekti i cilësisë së mësimdhënies dhe i kushteve në të cilat do të fillojë mësimi. A kemi rënie të nr. të nxënësve , nëse po cila është aryesyea. Gjitashtu cili është numri i mësimdhënësve në raport me numërin e nxënësve. Neve na duhet një raport i tillë nga Drejtoria e Arsimit.

Nebih Bibaj: Ne jemi për mbrojtjen e vlerave të luftës pa dallim partie ne edhe në këtë rast të z. Thaç dhe Veseli besojmë në trumfimin e tyre përballë këtyre akuzave sepse lugta e tyre ishte drejtë.

Kryetar ka shume deponi të mbeturinave që janë skadaloze në K. e Malishevës e është mirë që të mirreni me këtë shqetësim të qytetarëve.

Kryetar, Gjiraku nuk ka shkollë, përveç kësaj ata nuk kanë as trotuar dhe nxënësit vijnë në shkollë te ju në Banjë.

Te lapidari në Lladroc nuk ka ndriçim publik pavarësisht asaj që ishin në projekt edhe pse është bërë pranimi teknik.

Shqetësim për banorët e fshatit Drenoc është edhe kanalizimi te “Livadhet e gjata”. Këtë çështje e kam ngritur edhe njëherë.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Sa i përketë temës të aktakuzave për krerët e UÇK-së mendoj që është politike sepse lufta e UÇK-së ishte shumë e pastër. Për këtë propozoj në emër të PDK-së dhe kërkoj mbështetjen e të gjitha grupeve tjera politike që ne të dalim me një deklarat për mbrojtjen e luftës së UÇK-së si Kuvend Komunal.

Kryetar një ditë Milaim Mirusha tha që 1 vit ja kanë ndalur socialin. Kjo është e prapranueshme si i ndalet sociali një personi me aftësi të kufizuara. Kryetar merrni masa për këtë sepse kjo është jonjerzore.

Kryetar, trotuari në fshatin Llozicë është i shtruar në anën e kundër për të shkolla dhe kur ka rreshje me shi po u mbulojkua me ujë dhe po u bllokuaka.

Kryetar, kishe marrë një vendim në mars me shumë 1,020,000€ për mirëmbajtjen e rrugëve për vitin 2020-2021. Ju çdo ditë vini nga Banja dhe në hyrje të Malishevës rrugën e ke në gjendje të mjerushme. E njëjtë është edhe rruga “Imer Krasniqi” në drejtim të Mirushës.

Për fund ja uroj pozitën që ka marrë si Këshillëtar politik i Ministrit të Arsimit Luan Kryeziu!

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Disa nga shqetësimet e qytetarëve janë për investimet kapitale që janë duke shkuar shumë ngadalë pavarësisht që ne e dimë që pandemia ka qenë pengesë por gjatë asaj kohe keni mund që t’i përgatitni dhe pastaj të ishin gati për tenderim. Pra këtu kemi një ngecje shumë të madhe që nga viti 2018, 2019 dhe ky 2020. Përveç vonesave ka edhe devijim të projekteve nga të buxhetuara dhe në bazë të planit të prokurimit dhe për këtë çështje veç e kemi adresuar një kallëzim penal në organet përgjegjëse.

Rruga “Mullah Selimi” ka qenë e tenderuar për t’u asfaltuar por shtrimi i saj nuk ka filluar akoma dhe është projekt i vitit 2019. Në rrugën që shkon për Gajrak nga Maralia ka deponi të mbeturinive Kryetar duhet të merren masat për këtë.

Hamëz Bytyqi: Pershendetje për të gjithë! Kryetar ka projekte për Shkozën ama që 2 vjet asnjë projekt nuk është investuar. Që 2 herë ndajmë mjete edhe për fushën e sportit por ai projekt as që ka filluar. Përveç ndriçimit publik prej 20 dritave asnjë projekt tjetër nuk është bërë. Ku është problemi, Kryetar?

Sadije Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kam një shqetësim të banorëve të fshatit Drenoc në lidhje me projektet e parapara dhe kur do filloj projekti për kanalizimet sepse gjendja është e keqe dhe në pyetje është shëndeti i qytetarëve.

Rruga “Mirtush Kuteli” kur do të përfundoj? Problem në këtë rrugë është edhe kanalizimi dhe a do të përfundoj në kohë ky projekt?

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Lufat e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe fal gjakut dhe sakrificës së saj ne sot jemi këtu të lirë. Lufta e UÇK-së duhet të mbrohet që nga ushtari i thjeshtë e deri te krerët e saj. Pra, ta mbrojmë luftën si të tërë sepse kur dënohet ushtari dënohet lufta në tërësi.

Gjendja e kanalizimeve në K. e Malishevës është shumë e keqe dhe kërkoj që t’i organizoni drejtorët që të dalin në terren dhe ta shohin gjendjen reale si si është ku rrezekohet edhe uji i pijes.

Në projekt buxhet të viti 2019 ka qenë i paraparë edhe shtrimi i trotuarit në rrugën “Hilmi Hoti” , por ky projekt nuk është realizuar.

Kryetar, kemi dëgjuar që keni bërë reforma në disa drejtori me ndërrimin e disa drejtorëve dhe është mirë që t’na prezantoni ata emra.

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë! Kam një kërkesë për Kryetarin për lirim të hapësirës në rrugën “Sylejman Vokshi” është mirë që ju Kyetar të dilni në terren dhe të shihni se si na janë bllokuar dyert e shtëpisë që e pamundësojnë hyrjen dhe daljen nga shtëpia. Pres një përgjigje për këtë dhe nëse nuk merrni ndonjë masë ne si qytetarë do të organizohemi dhe do t’i heqim vet ato pengesa prej 0.30m.

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Lufta e UÇK-së duhet të mbrohet sepse ajo është e pastër. Nëse ka ndonjë rast individual le të merren si raste të tilla e jo të njëlloset lufta e pastër e UÇK-së.

Kryetar, kam një kërkesë nga komunitet për banesën kolektive se si dhe kur të aplikojnë ata për një banesë të tillë siç është familja e Fadil Mazrekut?

Sa i përket investimeve kapitale 2018, 2019 janë neglizhuar puntë për këto investime. Tenderimet hapen në shtator-tetor për sezonën e dimrit kur edhe nuk mund të punohet.

Kryetari- Ragip Begaj: Pershendetje për të gjithë! Lufta e UÇK-së ka qenë pastër dhe e drejtë dhe është mirë që t'i ruajmë vlerat e luftës pa i dënuar njerzit e saj. Unë kam qenë pjesë e luftës UÇK-së dhe jam pjesë edhe sot në mbrojtjen dhe pasojat e saj.

Në fillim është dashur që projekt-buxheti të bëhet i realizueshm por ju nuk më keni lejuar ashtu siç e kam paraparë unë prandaj edhe krejt projektet nuk realizohen siç duhet sepse ka projekte që janë 2 vjeçare e ju i keni paraparë buxhetin veç për 1 vit.

Alban, çerdhja në Malishevë është në procedurë dhe besoj që do të lëshohet por për Kjevë nuk e di a mund ta lëshojmë sivjet.

Ne për trotuar kemi probleme me pronësinë, sepse e gjithë rruga për Gajrak kalon nëpër prona private të cilën vullnetarisht e kanë liruar qytetarët. Besoj që shumë shpejt do të shtrohet edhe ai trotuar sepse e kam në planet e mija.

E thash më heret që me kanalizime kemi për të pasur probleme edhe disa vitet sepse nuk ka pasur më parë. Kërkohen mjete të shumta për të ndërtuar rrjetin kryesor e të sanohen problemet tjera.

Hamëz, i kemi disa rrugë të kontraktume për fshatin Shkozë. Aty m'ka dal problem me një muri për ndërtimin e fushës së sportit. Sinqerisht më vjen keq për këtë.

Ilaz, e di që disa kanalizim janë keq e janë punuar keq në Carrallukë e vetmja mënyrë është tash me mirëmbajtjen e kanalizimeve të sanohen edhe ato probleme atje.

Kastriot, do të dal në terren dhe do ta shoh gjendjen e asaj rruge dhe varësisht sipas gjendjes do të vperojmë.

Hidajete, pa u plotësuar të gjitha kushtet nuk mund të lëshohen banesat kolektive, do të zgjidhet problemi i ujit dhe të rregullohet më pas rryma pasi të përfundojnë të gjitha këto do të lëshohen banesat e komisioni do të vendos për nevojtarët.

Rrahim Morina: Kishim një kërkesë nga grupi i PDK-së për Kuvendin që të nxjerret një deklaratë për luftën e pastër të UÇK-së. A doni një pauzë që së bashku ta harmonizoni atë deklaratë, apo doni që të diskutoni paraprakisht?

Avdi Morina: Realisht ky propozim sipas praktikës së mbledhjeve tjera kjo duhet të futet në rendin e ditës si pikë më vete. Pastaj aty të diskutohet e të përpilohet ajo deklaratë e të votohet më pas këtu.

Alban Krasniqi: Kjo tregon se sa çmohen dhe respektohen këtë vlera e sa jo serioz ishte propozuesi. Sepse në emër të kësaj UÇK-je krejt marrëveshjet me Serbinë i kanë bërë duke e caktuar edhe vendin jo për intersin më të gjërë të kësaj çështje ata është dashur që vijnë më një copë letër këtu. I pari e ka votuar Kadri Veseli këtë gjykatë, e me polici e keni mbrojtë. Tash kjo ka pasoja e po i kushton sot Kosovës.

Po, ne e mbështesim deklaratën por me kushte të caktuara e joshfajqësuese. Ne do ta japim versionin tonë.

Alban Mazreku: Alban, s'po e di kush po moralizon më shumë këtu! Ne nuk deshëm të nxjerrim deklaratë për individë të caktuar por për luftën e pastër të UÇK-së. Ne e bëmë si propozim dhe kërkuam mbështetjen e juaj, e ju vendosini a do ta mbështesni apo jo. Po kjo është mirë që të futet si pikë në rendin e ditës.

Rrahim Morina: Pra, propozimi i PDK-së është të futet në rendin e ditës si pikë e veçantë për nxjerrjen e një deklaratë për mbrojtjen e luftës së UÇK-së. Unë kam edhe disa materiale për disa pika shtesë që kërkojnë të futen në këtë rend dite.

Nën 1. Janë dy procesverbale, 2 . është shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Komitetit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidë dhe Veteranë të Luftës së UÇK-së. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve në Komunën e Malishevës dhe janë 2 vendime që i kemi marrë më heret për ndarjen e mjeteve finaciare për Qendres Mazrekun dhe Adnan Krasniqin. Nga projekti i Parkut të Maralisë ku është dashur të ndahen këto mjete nuk ka pasur mjete dhe këto 2 vendime kanë mbetur të parealizuara e tani drejtori ka kërkuar që këto

mjete të merren nga subvencionet. Po e hapi debatin që a jeni që këto propozime të futen në rendin e ditës.

Hashim Vrenezi: Ne i kemi anashkaluar disa pika të rendit të ditës nga mbledhjet e kaluara dhe ne është dashur që të kemi informacione se çka u bë me ato pika të rendit të ditës se më s'kanë ardh për shqyrtim të cilat momentalisht të gjitha s'po m'kujtohen siç ishte kërkesa jonë e PDK-së për pasurinë e K. së Malishevës etj.

Propozoj që të hyjë në rendin e ditës edhe një pikë që ne edhe më heret e patëm propozuar për faljen borxheve ose një pjese të tyre për vitet e mëhershme nga bizneset pasi që sot e kemi edhe Rregulloren për Taksa dhe Tarifa Komunale.

Rrahim Morina: Hashim, kërkesat ashtu siç i drejtoni ju në KPF ashtu i përcjelli edhe unë për te Kryetari dhe në Kuvend.

Alban Krasniqi: Për hir të opinionit publik kërkesa për faljen e borxheve është e të gjithëve dhe është e drejtuar për KPF-në. Është mirë që kjo temë të specifikohet edhe më shumë sepse nuk mundesh me ja fal borxhin si një këpuctari ashtu edhe një gurthyesi. Është mirë që të shikohet e të rishikohet se çka mund dhe çka s'mund të falim. Është mirë që kjo të jetë si pikë e rendit të ditës për një mbledhje tjetër deri sa të përgatitet materiali i detajuar.

Avdi Morina: Ne sot kemi një pikë të rendit të ditës për shqyrtimin e Rregullores për tarifa dhe taksa komunale e kjo temë mund edhe të diskutohet aty. Ne patëm propozuar që të falen borxhet për vitin 2020 për shkak të gjendjes që ka krijuar COVID-19. Ne nuk mund të falim borxhe që dikush në vitin 2016, 2017, 2019 etj. për shkak që nuk ka dashur t'i paguaj këto obligime pavarësisht fitimit që ka pasur. Ne gjithashtu duhet të kemi një material se kujt dhe për çfarë arsyeje duam t'ja falim borgjet. Ne jemi kundër që sot të futet kjo si pikë e rendit të ditës.

Alban Mazreku: Propozim i yni ishte që të futet si pikë e rendit të ditës edhe kompanitë edhe qytetearët që kanë borxhe t'ju falen por në bazë të kritereve që vendosim ne këtu.

Valon Krasniqi: Ne jemi duke diskutuar tani për rendin e ditës dhe ne kërkojmë që secili propozim të hudhet veç e veç në votim e pastaj cila t'i merr votat të futet në rendin e ditës.

Hashim Vrenezi: Është mirë që këto dy pika t'i trajtojmë ndaras. Tregona Kryetar se cilat janë hapat që keni marrë për kompanitë që sa e sa vite ju kanë mbet borxh?

Rrahim Morina: Shkojmë në votim për secilin propozim veç e veç. A jeni që të futet në rendin e ditës për një deklaratë për mbrojtjen e luftës së UÇK-së të propozuar nga PDK-ja? Kush është për?

Për: 21 (unanimisht)

Propozimi im është: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së I-rë të jashtëzakonshme dhe mbledhjes së I-rë të rregulltë për vitin 2020? Kush është për?

Për: unanimisht

Propozimi i tretë është: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve në Komunën e Malishevës. Kush është për?

Për: 22 (unanimisht)

Propozimi i 4-ërt është: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Komitetit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidë të Luftës, Veteranë të UÇK-së si dhe Martirë të Luftës. Kush është për?

Për: unanimisht

I kemi edhe 2 vendime për rishqyrtim, Muharrem si të veprojmë?

Muharrem Morina: Pershendetje për të gjithë! Kryesues së pari është dashur që të konsultohesh me ne para se këto vendime të vinin këtu. Ju nuk keni nevojë që t'i ndryshoni vendimet këto veç plotësohen dhe ndryshohen ku është i cekur në përshkrimi zëri buxhetor.

Rrahim Morina: Është pra plotësim-ndryshim i këtyre vendimeve tek për shkrimet. Kush është për?

Për: 21 (unanimisht)

Kemi edhe kërkesën e Hashimit për faljen e borxheve të akumuluar deri në vitin 2019. Kush është për?

Për: 7

Kundër: 13

Abstenim: 1

Pas votimit të këtyre propozimeve shkojmë në votim për rendin e ditës në tërësi të plotësuar.

Kush është për?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 6

Shkojmë në pauzën e drekës kthehemi në ora 13:00.

Kthehemi në mbledhje pas pauzës së drekës dhe asaj për hartimin e deklaratës për mbrojtjen luftës së UÇK-së dhe në emër të të gjitha grupeve politike Sylja e lexon Deklaratën.

Sylë Dukolli: Ne përfaqësuesit e grupeve politike u dakorduar që deklarata të jetë kjo:

Deklaratë:

Ne anëtarët e Kuvendit Komunal të Malishevës nëpër mejt kësaj deklarate konsiderojmë që Gjykata Speciale është padrejtësia më e madhe që u është bërë shtetit të Kosovës që pas Shpalljes së Pavarësisë së saj.

Lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë, e pastër dhe që ka mbrojtë popullin nga shfarosja e forcave pushtuese serbe. Andaj, Kuvendi Komunal i Malishevës mbronë fuqishëm luftën Çlirimtare të UÇK-së dhe vlerat e saj sublime.

Rrahim Morina: Atëherë shkojmë në votim. Kush është pro kësaj Deklarate për mbrojtjen e luftës së pastër të UÇK-së?

Për: 20 (uanimisht)

Me këtë votim miratohet edhe kjo Deklaratë.

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së I-rë të jashtëzakonshme dhe mbledhjes së I-rë të rregulltë për vitin 2020? E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s'ka debat, atëherë kush është pro aprovimit të këtyre 2 procesverbaleve?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 3-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Komitetit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidë të Luftës, Veteranë të UÇK-së si dhe Martirë të Luftës.

Kryesuesja e këtij Komiteti nuk është këtu por fjalën ja japim anëtarit të këtij Komiteti Ilaz Krasniqit.

Ilaz Krasniqi: Kërkoj falje që ky raport ka ardhur sot dhe është me vonesë por shkak i Pandemisë puna është kështu! Raportin e keni secili para jush dhe nuk kam se çka t'ju flas më shumë.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë. Kush e do fjalën?

Mbase s'ka diskutues e hedhi në votim. Kush është pro miratimi të këtij Raporti të Punës të Komitetit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidë të Luftës, Veteranë të UÇK-së si dhe Martirë të Luftës?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 4-ërt të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregulloreve për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve në Komunën e Malishevës. Valoni ishte Kryetar i Komisionit për hartimin e kësaj Rregulloreje dhe ai e ka fjalën.

Valon Krasniqi: Ju informoj që Komisioni gjithësej ka mbajtur 6 mbledhje për shqyrtimin e kësaj Rregulloreje. Gjatë këtyre takimeve ka bërë plotësim-ndryshimin aty. Kjo draft-Rregullore ka qenë për lexim të parë në Kuvend, ju ka nënshtruar dëgjimit publik dhe është bërë gati për këtu.

Rrahim Morina: Nëse pajtoheni kishim shkuar me debat veç në nivel shefish të grupeve politike.

Mirë, mbase s'ka diskutues po e hudhi në votim. Kush është pro që të miratohet Draft-Rregullorja për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve në Komunën e Malishevës?

Për: 20 (uanimisht)

Kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës: Plotësim-ndryshimi i 2 vendimeve. Fjala është për vendimin që është bërë për ndarjen e mjeteve për Luljeta Mazrekun, dhe vendimi për ndarjen e mjeteve për Adnan Krasniqin në vlerë nga 1000€ dhe paratë është dashur të merren nga projekti i Parkut të Maralisë. Mjetet aty janë shpenzuar dhe vendimet kanë mbetur pa u zbatuar. Materiali po ju bëjë gati e deri sa materiali të vije po kalojmë në pikën tjetër.

Sipas radhës jemi në pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/112 datë:11.06.2020, të parashtruar nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2021-2023. Ju kërkoj falje sepse edhe ky material është shpërndarë me vonesë! Për këtë drejtori e ka fjalën.

Valon Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Ne e kemi paraqitur Kornizën Afatmesme Buxhetore në bazë të Qarkores Buxhetore 2020/1 për nivelin lokal. Në KAB janë pasqyruar prioritetet e qeverisjes për K. e Malishevës. Këtë e kemi trajtuar në KPF dhe i kemi përmirësuar ato gabime teknike që ka pasur.

Buxheti i planifikuar nga niveli qendror për K.e Malishevës është 15,218,977.00€. Ky është buxheti total. Në kuadër të këtij totali ne i kemi ndarë në 5 kategori ekonomike. Sa i përketë kategorisë Paga dhe Meditje e kemi përjashtu ligjin për paga sepse për vitin 2020 pagat janë buxhetuar dhe janë miratuar në Kuvend sipas ligjit të ri të pagave, por në këtë vit në qarkore pagat nuk janë planifikuar pagat sipas ligjit të ri. Pra ky është ndryshimi në këtë kategori ku është zvogëluar shuma dhe janë rritur vlerat në kategori tjera. Këtë e keni të pasqyruar në materialet e juaja.

Te kategoria Paga dhe Meditje është rritur edhe shifra e mjeteve por është rritur edhe stafi sepse sipas Drejtorisë së Shëndetësisë për një 1000 banorë duhet një mjek dhe 2 infirmierë. Duke llogaritur nga kjo neve na takojnë afërsisht edhe 15 mjekë familjarë. Edhe Drejtoria për Arsim dhe Edukim ka bërë një kërkesë për rritje të nr, të stafit ku ne e kemi pasqyruar në këtë kornizë për rritjen e stafit për çerdhet e reja që i kemi edhe në projekt-buxhet.

Ne e kemi bërë një ndarje të buxhetit për 5 kategoritë ekonomike.

1. Te Pagat numri i të punësuar faktikë tani është 1345 dhe nga totali i buxhetit për këtë kategori janë 8,303,200.00€. 2.
 2. Për Mallëra dhe Shërbime 1,529,526.00€ është e njëjtë sikur vitin 2020.
 3. Te kategoria Shërbime Komunale shuma është e njëjtë sikur në vitin 2020 shuma është 455,000.00€
 4. Te Subvencionet shumat janë rritur nga 20,000.00€, kemi kërkuar që të paktën shuma të jetë 400,00.00€.
 5. Te Investimet kapitale janë 4,531,251.00€ afërsisht janë më shumë se viti 2020 700,000.00€.
- E gjithë kjo është e pasqyruar në materialin e juaj.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Hashim Vrenezi: KAB me përmirësime e morem sot dhe nuk mund ta pa tërësisht dhe shpresoj që ato gabime teknike janë rregulluar. Kam analizuar edhe disa KAB të komunave tjera ku kam parë një prezantim më të mirë dhe më të qartë.

Kam bërë edhe një analizim edhe të vijave buxhetore sipas Qarkores Buxhetore dhe aty thuhet që deri më 30 qershor bëhet aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe me 30 shtator aprovimi i propozimit të buxhetit.

Në KAB kam nxjerru një informacion rreth 3 pagave jubilarë tek shpalosja për Malishevën ishin pagat dhe shtesat për mësimdhënësit, pra paskan nda buxhet për këtë vit për këtë kategori.

Kërkoj që t'i shihni praktikën e komunave tjera që janë të mira pse mos t'i ndjekim edhe ne ato praktika që shpalosjet të jenë më të detajizuara.

Alban Krasniqi: Si çdo vit teksti pothuajse mbetet i njëjtë me shumë pak ndryshime dhe askund nuk pash që i referohet diku COVID-19 dhe efektet anësore që do t'i ketë në vitin që vjen në ekonomi etj. Mendoj që ne nuk kemi me mund që t'i mbërrijmë ato të hyra që janë të planifikuara.

Nëse i shikojmë objektivat se si janë paraqitur dhe buxhetin në mënyrë të përgjithësuar se si është shpërndarë nuk korrospodojnë njëra me tjetrën.

Te arsimit u përmend një numër prej 15 të punësuarish për çerdhet. Me planifikim për ndërtim i kemi 2 çerdhe në Malishevë dhe Kjevë. A është ky numër për të dy çerdhet? Tek shëndetësia numri i punëtorëve është rritur, por neve na duhet një plan nga Drejtoria e Shëndetësisë se si shihet në funksionimin e përditëshëm në shëndetësi. Se si numri i të punësuarëve ka për ta përmirësuar kujdesin shëndetësor këtë plan duam ta shohim.

Drejtor kërkoj që vendimet e Kuvendit të mos i anashkaloni ato që janë paraparë me buxhet.

Sylë Dukolli: Kur bëhen planifikime të tilla për drejtimin që duhet t'ju jepet investimeve kapitale për 4 vjet duhet të marrin pjesë të gjitha drejtoritë nën drejtimin e Kryetarit dhe nën kujdesin e drejtorit të Financave për dalur sa më mirë dhe të jemi pranë asaj që planifikojmë. Çdo kornizë buxhetore ka efekt nëse përmirësohen shërbimet e qytetarëve.

Në secili vit janë shtuar mjetet tek investimet kapitale dhe kjo është një gjë e mirë. Mendoj që në Kjevë duhet të ndërtohet Çerdhja ashtu siç është planifikuar me buxhet dhe në bazë të vendimit që kemi marrë këtu.

Hidajete Mazreku: Përgatija e kësaj Kornize Buxhetore është në mënyrë formale. KAB është planifikim strategjik për 3 vite, jo kështu. Mund të dështoj 10-20% por jo më shumë. Në KAB është dashur që investimet kapitale të jenë më konkret dhe me të detajuar. Çka parashihet me investimet kapitale mbrenda 3 viteve?

Te kategoria e Pagave dhe Meditje të dhënat janë diku të zëvogëluar e diku të rritura pra janë në shpërputhje me atë që do të duhej të ishte. Nuk pas anjë arsytim pse janë zvogëluar apo janë rritur ato mjete.

Kur do të jetë mamografi, a është e paraparë në KAB kur keni bërë planet në shëndetësi?

A është e paraparë edhe shujta nëpër shkolla seps ekëtu askund nuk e pash?

Nebih Bibaj: Kam pyetje për drejtorin. Pse nuk është mbajtur dëgjim publik nëpër fshatra sepse qytetarët duhet të përfshihen në vendimmarrje? Pse projektet që janë të parapara për vitin 2021 nuk janë të përfshira në KAB, dhe të jenë të detajizuara për ku dhe sa kohe zgjasin?

Kushtrim Zogaj: Pershendetje për të gjithë! Te tabela nr. 3, te licencat dhe lejet për vitin 2020 janë të parapara 6,000€, në vitin tjetër bie shuma për 1,000€. Pse ndryshon kjo shumë? Te takasat administrative janë të 65,000€ e më pas në vitin tjetër bie 45,000€. Pse?

Te Drejtoria e Bujqësisë nuk është paraparë asgjë. Te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport te të hyrat nga Biblioteka nuk ka asnjë të hyrë. Pse?

Te tabela nr. 5, te mallëra dhe shërbime 1.52 mil për vitin 2020-2021 dhe përnjëherë shkon 2.52 mil për vitin 2022. Ky ndryshim është i madh.

Blerim Thaçi: Hashim, është e vërtetë që në vitin 2019 është përcaktu kodi për pagat përcjellëse.

Profesoreshë, nuk ka mundësi që të planifikohen shujtat sepse këtë planifikim e bënë qeveria qendrore e jo ne.

Ne stafin për çerdhe e kemi specifikuar mbi bazën e numërit të fëmijëve dhe të realizimit të projektit. Aktualisht pa përfunduar projekti nuk e dimë se sa fëmijë vijnë në çerdhe.

Valon Mazreku: Te shpalosja e projekteve në KAB disa komuna i aplikojnë por komplet Koriniza është e përgatitur nga Ministria dhe të njëjtën të gjitha komunat e aplikojmë por disa i pasqyrojnë projektet në mënyrë të detajuar, por ne nuk kemi mundur sepse ne nuk e kemi të saktë ndarjen e kategorive ekonomike. Qarkorja e II-të Buxhetore i saktëson saktë kufinjët dhe buxheti në total nuk ndryshon.

Ne Rregullore për Subvencione dhe Trasfere ne kemi pasur Alban dhe janë shkuar në bazë të rregullores.

Ndryshimet profesoreshe, ndodhin sepse ndryshon edhe buxheti në total dhe varet nga të hyrat që akumulujmë.

Rrahim Morina: Kërkoj nga drejtori që të përfshihen të dy çerdhet me numrin e puntorëve në Kornizën e II-të Buxhetore. Kush është për që të miratohet KAB-i?

Për: 21 (unanimisht)

Atëherë kalojmë te dy plotësim-ndryshimet e vendimeve që kishim më heret. Materiali shëfave të grupeve ju dorëzua. Po e lexoj pjesën ku duhet të ndryshohet.

Për kërkesën nr.01/05 të datës 05.12.2019 e parashtruar nga Qamil Mazreku nga Malisheva për mbështetjen finaciare për shërim jashtë vendi të vajzës së tij Qëndresa Mazreku. Shuma që i është ndarë është 1000€ nga kodi për ndërtimin e Parkut në fshatin Marali. Meqenëse s'ka pasur mjete nga projekti i këtij parku drejtori ka kërkuar që këto mjete të ndahen nga subvencionet.

Valon Mazreku: Ka qenë vullnet i juaji që t'i mbështesni këto 2 familje me mjete finaciare. Vendimet janë marrë me dt. 17.12.2019. Kur ne i kemi futur në sistemin e pagesave këta 2 përfitues Ministria i ka vonuar dhe ka kaluar afati i pagesave sepse është në fund të vitit.

Rrahim Morina: Pra për të dy vendimet kërkesa e drejtorit është që mjetet të merren nga subvencionet ndërsa të dhënat tjera mbesin të njëjta. Kush është për?

Për: 22 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të shpenzimit të mjeteve për COVID-19. Fjalën e ka Kryetari.

Kryetari-Ragip Begaj: Përshendetje për të gjithë! Në fazën e I-rë të Pangemisë në ato 3 muaj kemi pasur një angazhim të madh si Malishevë dhe të gjitha i kemi shënuar në raport. Qysh në ditën e 12-të kemi filluar me punë të rregulltë dhe kemi formuar Shtabin Komunal për Menaxhimin e Emergjencave që ka qenë në dispozicion 24 orë. Shtabi ka mbajtur 35 mbledhje ndërsa Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim ka mbajtur 5 mbledhje.

Ka qenë një menaxhim i mirë i situatës dhe të gjitha i keni të cekura në raport me vendime e me udhëresa si dhe të gjitha të ardhurat nga donatorët. I jam mirënjohës të gjithëve atyre që kanë kontribuar në menaxhimin e kësaj situate gjithashtu edhe juve për gaditshmërinë e ofruar. Raportin e shpenzimeve do t'ju paraqes drejtori i Financave.

Valon Mazreku: Kryetari e pasqyroj pjesën e përgjithëshme të kësaj periudhe ndërsa sa i përket anës financiare e keni këtë tabelën ku janë të pasqyruar përfituesi i kontratës, operatori ekonomik, cila është forma e shpenzimit, sa është vlera e shpenzimit dhe cili është aktiviteti. Me një tabelë me të vogël janë mjetet që janë ndarë nga Kuvendi që janë 150,000.00€. Nga mjetet e shpenzuara nga kjo shumë deri me tani janë 62,062.46€. Mjetet e zotuar dhe në procedurë prokurimi janë 41,371.50€ dhe mjetet e lira janë 46,566.04€. Këtu e keni një sqarim që mjetet në zotim janë për furnizimin me pako ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë 20,000.00€, për dezinfektimin dhe pajisje me masa mbrojtëse për objektet shkollorë janë 15,000.00€ ndërsa vlera e kontratës 24,617.50€. Një pjesë tjetër e zotimit është për shërnime teknike për Qendren Operative Emergjente Lokale dhe një pjesë tjetër është për shërbime shëndetësore.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Ne kemi bërë një kërkesë për informacione bazë për situatën e krijuar nga pandemia dhe për mjetet bazë por këta nuk na dhanë informacione. Në këtë raport Drejtoria e Shëndetësisë dhe ajo e Inspektoriatit kanë bërë një përshkrim të detajuar të punës së tyre.

Vendimi i parë që ka nxjerrë Komuna është me 07.04.2020 e që deri ne atë kohë asnjë vendim nuk është marrë më parë për luftimin e COVID-19 dhe nuk janë zbatuar as rekomandimet që janë dhënë nga niveli qendror. Nga kjo datë ka ndryshuar edhe qasja juaj si ekzekutiv dhe keni bërë përpjekje për t'i dalur në krye të detyrës. E gjithë kjo përpjekje është bërë fal shtabit, subjekteve politike, kryetarët e fshatrave, qytetarët etj.

2000€ janë shpenzime për ushqime për Shtabin Emergjent Komunal. Ne masandej kemi kërkuar që t'na tregohen arsyet e anazhimit me kontrata në vepër aty.

Ne kur e kemi marrë vendimin kanë qenë të specifikuara të gjitha arsyet për çka ndahen këto mjete. Ne deri me sot kemi parë veç mielli që është blerë por jo edhe përbërsit e tjerë të asaj pako për gjithë atë shumë që ne kemi ndarë.

Për dezinfektim 4,750.00€ është blerë kabina spërkatëse në oborrin e QKMF-së e cila ka funksionuar 3 ditë. Të njëjtën kabinë Komuna e Lipjanit e ka blerë 1,950.00€. ngajshëm me Lipjanin e kanë blerë edhe komunat tjera. Pse veç e jona kushtoj aq shtrenjët?

Dua të di Kryetar, kryetarët e fshatrave a kanë marrë ndonjë pagë për punën e palodhshme që kanë bërë gjatë kësaj kohe?

Hashim Vrenezi: COVID-19 në komunën tonë pati filluar shumë keq me krantinimin e Malishevës nga Kryeministri i cili ishte një veprim i ngushtëm dhe i gabushëm. Është dashur që të karantonohen lagjet e prekura me grip e jo Malisheva në tërësi. Njerzit e infektuara mundshen që të lëvizin mbrenda Malishevës sepse ne si komunë u karantinuan jo veç aty ku kishte raste e virusi u shpërnda lehtë.

Kryetar në momentin kur keni pasur të infektuar në lagjen tuj ju kemi marrë vendime të gutshme dhe të pamenduara mirë. Ju keni nxjerrë në urshëresë keni harruar që t'ju mundësohet që të punojnë edhe pomat e derivateve. Në bazë të asaj urdhërese policët kanë kthyer transportues të derivateve. Malisheva ka qenë në një krahurë në mungesë të informacioneve, keqkuptimeve dhe mos organizim të duhur në menaxhimin e situatës me pandemi.

Zinxhiri funksionues që shërben në mirëqenien e qytetarit ka qenë i lejuar nga Ministria por ju është dashur që t'i respektoni dhe nuk kemi pasur nevojë që të nxjerrim vendime ekstra dhe ta ngulfatmi biznesin në komunën tonë. Kjo ka pasoja të mëdha ekonomike.

Kryetar, ju keni mbyllur insitucionet finaciare në Malishevë dhe qendrat e pagesave, ky është vendim i gabuar sepse qytetarët në mënyrë ilegale kanë dal në komunat tjera për t'i kryer shërbimet e domosdoshme.

Ne kemi kërkuar që t'i sillni kontratat me operatorët dhe listën e shërbimeve me çmime që i keni kontratuar sa i përketë raportit të shpenzimeve. Psh: Dezinfektimi i objektit të komunës, QKMF-së dhe shkollave është dashur ta keni të specifikuar për m² për secilin objekt. Pse nuk i keni publikuar kontrat me çmime ashtu siç keni bërë me kontratën e miellit?

Muharrem Morina: Disa veprimtari janë ndaluar dhe lejuar prej qeverisë qendrore dhe urdhëresa konumale nuk ka dal mbi to. Marketet e mëdha, pompat e benzines kanë qenë të rregulluara nga Qeveria e Kosovës jo nga K. e Malishevës ato kanë punuar gjithë kohës me orarin e caktuar.

Ilaz Krasniqi: Kam qenë pjesë e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe në këtë komitet kanë raportuar edhe policia. Ata kanë raportuar për problemet e tyre sepse ka pasur rast që ka pasur 2 vendime një nga Qeveria e Kosovës dhe vendimin tjetër që është nxjerrë nga Shtabi Emergjent. Qëllimi nuk ka qenë i keq por për mbrojtje u vendos karantinë mbi karantinë siç ishte rasti i Banjsë. Pra ndonjëherë as ata nuk kanë ditur se cilin vendim ta zbatojnë të cilët ndonjëherë kanë rënë në kundërshtim me njëri-tjetrin.

Kur është nxjerrë ajo vendimi i Komunës Hashim disa veprimtari nuk janë të shënuara që ndalohen e ato që s'janë ndaluar janë të lejuara kështu na është sqaruar në shtab.

Me vendimin e qeverisë qendrore kanë qenë të ndaluara shërbimet në restorant përveç rasteve kur ushqimi merret me vete, këtu disa kanë shërbyer, berberët kanë qenë të ndaluar këtu ka pas raste kur dikush ka punuar etj e këto na kanë kushtuar neve.

Sadije Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ky raport është i detajuar dhe me plot aktivitete e përkëtë duhet falemnderuar mantilbardhërt, donatorët, kryetarët e fshatrave, Kryetarin me gjithë stafin e tij e të gjithë ata që kontribuan në përballje me këtë situatë.

Pandemia ende nuk ka kaluar andaj nuk është momenti me dhënë kritika e të hudhet poshtë çdo punë e mirë që është bërë, mirëpo është mirë që të gjithë të japim kontributin tonë e t'i ndihmojmë qytetarët.

Halil Morina: Pershendetje për të gjithë! Komuna jonë në fillim ishte më e prekura me këtë virus. Pajtohem me Hashimin që karantinimi i tërsishim i K. së Malishevës ishte një gabim i qeverisë që jo me i karantinu rastet por në tërësi Malishevën që aty mbrenda le të shpërndohet por mos te del jasht saj.

Detyra e komunës në menaxhimin e kësaj situate kryesisht ka qenë logjistike duke i zbatuar qato vendime që ka nxjerrë qeveria dhe të kujdeset për qytetarët e saj. Asnjë familje në K.e Malishevës nuk ka vuajt për ushqim dhe pako higjienike e kujdes mjeksor, të gjitha këto i ka kryer komuna me sukses. Komuna ka bërë dezinfektime të vazhdueshme në çdo vend. Virusin s'ka mund me ndal as shtetet ma të zhvilluara në botë, këtë s'mund ta ndal as Kryetari i komunës sonë sepse ai ka bërë më shumë se ka pasur mundësi.

Rrahim Morina: Gjatë kësaj kohe ka pasur edhe lëshime por në situata të tilla edhe mund të ndodhin. Ne kemi drejtuar një kërkesë me shkrim për mjetet e ndara nga ky Kuvend 150,000.00€ se si janë shpenzuar këto mjete me detaje, por këtë përgjigje nuk e kemi marrë. Ne duam të dimë se ku kanë shkuar këto mjete Kryetar e mos ta akuzojmë njëri-tjetrin?

I falemnderoj të gjithë donatorët që na kanë ndihmuar në kohën më të vështirë dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë situatë!

Alban Mazreku: Ne Kryetarin e kemi ndihmuar me vendimin e Asmblesë me ndarjen e mjeteve si dhe me gaditshmërinë për ta ndihmuar Kryetarin në çdo mënyrë dhe kohë.

Kryetar, në urdhëresën e parë e dtës 07.04.2020 që ka nxjerrë zyra juaj është ashtu siç tha Hashimi ku cekën veç veprimtaritë që lejohen.

Në urdhëresën e dytë të datës 15.04.2020 lejohen edhe disa veprimtari siç janë pompat e benzinës, institucionet finaciare, depot e grurit etj.

Kryetar, si ka ardh burimi i infeksionit në fshatin Banjë?

Kryetar, gjatë kësaj kohe keni marrë punëtor në punë a na tregoni ku dhe për çfarë pune i keni marrë?

Mbase paska ende mjete të pashfrytëzuara është mirë që të dezinfektoni rrugër dhe hapësirat publike.

Valon Krasniqi: Dua të i falemnderoj të gjithë ata donatorë, mërgimtarë dhe të gjithë ata persona që kanë kontribuar gjatë kësaj kohe! E falemnderoj Kryetarin për punën që ka bërë, anëtarët e Shtabit Emergjent dhe juve kolegë të Asamblesë!

Kryetari- Ragip Begaj: Këto akuza nuk dojnë koment! Ky është opinionimi i juaj. Është mirë që të kontaktoni me familjet e atyre të prekurëve me COVID-19 dhe ndoshta mund të ndërroni opinion. Më vjen keq që këtu i thoni këto dezinformata dhe gjëra të pavërteta.

Ju po më detyroni që mos t'ju përgjigjem asnjëherë sepse ju si po i kërkon përgjigjet unë nuk mund t'ju jap sepse realiteti nuk është ashtu siç po e shihni ju.

Me 12.05.2020 ne kemi marr vendim që të fillojmë me Shtabin Emergjent Komunal dhe të gjitha takimet që janë mbajtur kanë qenë të shënuara në raport si dhe të gjitha vendimet që janë marr janë publiku.

Të gjitha vendimet që ka marrë Qeveria e Kosovës i ka zbatuar Komuna e Malishevës dhe izolimi i Malishevës është bërë nga qeveria qendrore ne e kemi pranuar si vendim.

Alban, është përgjegjësi e Institutit të Shëndetësisë me dhanë përgjigje që nga ka ardh virusi në Kosovë dhe Banjë. Unë nuk e di!

Hashim Vrenezi: Kryetar, unë ju dhash vërtetë e nuk ju akuzova për keqpërdorim asnjëherë nuk të thash "hajn". Urdhëresa administrative që është nxjerrë me datë 07.04.2020 aty nuk është e specifikuar që lejohen të punojnë pompat e derivateve. Në urdhëresën tjetër me 15.04.2020 pika e 1, shkruan që: kompanitë shitjeve të derivateve lejohen. Pra fola me argumente Kryetar.

Muharrem Morina: Çështja e marketeve, pompave dhe të shërbimeve që kanë qenë të domosdoshme kanë qenë të lejuara gjatë gjithë kohës me vendim të qeverisë qendrore. Ato ne as nuk i kemi ndaluar e as lejuar.

Urdhëresën që po e përmend Hashimi disave nga juve dhe Kryesuesi unë ju kam dërguar në msn. Në urdhëresën e 2-të për shkak të paqartësisë të policisë e kemi shkruar edhe atë urdhëresë.

Çdo masë është marrë në kordinim me Kuvendin përkatësisht me Komitetin për Mbrojtje dhe Shpëtim edhe këto urdhëresa. Mos harroni që ka qenë një kohë e rrezikshme nën kërcënimin e virusit. Ka qenë e vështirë që ta menaxhosh situatën në mënyrën strikte.

Rrahim Morina: Kalojmë në pikën e 8-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020. Fjaleë e ka drejtori.

Valon Mazreku: Ne të gjithë së bashku u dakorduam për ndryshimet që bëme në Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020.

Për keqpërdorim të ujit të pijes u ndryshua nga 100€ në 200€ është gjoha mandatore.

Për hedhje të mbeturinave në vendin jo të duhur gjoha është 200€

Për vendosje të panos reklamuese pa pëlqim të organeve kompetente gjoha është 100€

Për mallërat me afat të skaduar dhe të dëmtuar gjoha është 500€

Prerja e asfaltit, vendosja e pengesave pa pëlqim nga organet kompetente gjoha është 500€

Te ushtrimi i aktivitetit biznesor për nxjerrjen e zhavorit, thëngjillit, gurit gëlqeror dhe xehjeve tjera të ngjajshme sipas klasifikimit standard të veprimtarive tarifa vjetore është 1000€

Për qendrat tregtare, supermarketet tarifa vjetore është 700€

Tregtia me pakicë e karburanteve dhe derivatetve të naftës bizneset të cilat gjenden në rrugën rajonale ngarkesën e kanë 100€, ndërsa për bizneset të cilat gjenden mbrenda rrugëve lokale nuk kanë ngarkesë fare.

Te veprimtaritë përcjellëse dhe shërbyese faqe 10, shërbimet bankare, monetare dhe kredituese, filialet e bankave ngarkesa është 1000€

Shërbimet e ndërmjetsimit mikrofinanciar ose organizatat mikrofinanciare ngarkesën e kanë 700€

Shërbimet postale dhe të komunikimit telefonik ngarkesën e kanë 500€

Distributorët e energjisë elektrike ngarkesën e kanë 1000€

Tek veprimtaritë profesionale siç janë noterët, ngarkesa është 100€

Pika 20.7, shfrytëzimi i objektit në pronësi të komunës sallat e kulturës, stadiumet dhe vendet të gjajshme për manifestime të ndryshme ngarkesa është 50€

Pagesat për barjtjen e udhëtarëve për transportin rrugor në territorin e komunës nuk kanë ngarkesë

Kompanitë e transportit rrugor të udhëtarëve të cilët kanë më shumë se një vijë urbane pagesa është liruar pra është 0

Në faqe 20, tek Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport përkatësisht Biblioteka e Qytetit ndryshim është bërë për nxënësit e shkollave fillore pages është 0, nxënësit e shkollave të mesme pagesën e kanë 0, dhe të rriturit pagesa është 0 pra është hequr pagesa

Te shfrytëzimi i palestrës për stërvitjen e kulbeve private dhe stërvitjen e lira sportive për një orë pa ndriçim pagesa është 0

Te neni 27.3, për shfrytëzimin e palestrës sportive për manifestime dhe ngjarje të ndryshme si komerciale, panairë, revy, espozita, fushata politike, për një orë ngarkesa është 150€. Për ngjarje humanitare, seminare edukative, akademi përkujtimore, fushata edukative etj shfrytëzimi i palestrës është gratis. Ndërsa për të gjitha klubet që nuk janë të komunës së Malishevës tarifa nga 100 është bërë në 50€.

Te shfrytëzimi i Shtëpisë së Kulturës “Tahir Sinani” prej 1-3 është 0, ndërsa për tubime elektorale është bërë 50€.

Këto ishin ndryshimet në këtë Rregullore.

Muharrem Morina: Kryesues, te votimi ata anëtarë të Asamblesë që kanë përfitime nga kjo Rregullore le të deklarohen dhe të tërhiqen nga votimi sepse hyjnë në konflikt interesi.

Rrahim Morina: Drejtori i lexoj ndryshimet që janë bërë në këtë Rregullore. Atëherë kush është pro miratimit me ndryshime të -Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2020?


Për: 16 (unanimisht).

Me këtë votim miratohet Rregulloreja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2020.

Me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur duke ju falemnderuar për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 16:30.

Procesmbajtësja: Samir Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina

